5.	Can ÖZGÜR NR. ID-je në Republikën e Turqisë: 14194753284	Lagjia “Angora”, rrugica “Çınar Ağacı” Nr. 2, Kompleksi “Yeni Ladin” Beysukent/ANKARA	Republika e Turqisë

NENI 2: EMËRTIMI I SHOQËRISË

Emërtimi i shoqërisë është “SHOQËRIA ANONIME E INDUSTRISE SË NDËRTIMIT DHE TREGTISË “CEMIL ÖZGÜR””.

NENI 3: QËLLIMI DHE OBJEKTI I SHOQËRISË

Brenda dhe jashtë vendit:

- A.** Angazhimi, kryerja vetë ose nëpërmjet të tretëve e ndërtimit të ndërtesave, digave, rrugëve (infrastrukturë nën dhe mbi tokësore, përzierje e nxehtë me bitum, mbulesat me beton dhe asfalt), aeroporteve (pista, plsatforma taksirat, platforma dhe ndërtesa), impianteve industriale, komplekseve, spitaleve, shkollave, komplekseve të likuidimit të banesave, linjave të transmetimit të energjisë, porteve, urave dhe ndërtimeve të ngjashme, si dhe punime instalimi, që do të tenderohen nga ana e institucioneve shtetërore, formacionet ekonomike publike, entet publike dhe private, kooperativat dhe institucionet e tjera ose marrja me transferim e punëve të ngjashme me këto dhe realizimi i tyre,
- B.** Ngritja, vënia në funksionim, marrja me qira dhe dhënia me qira e komplekseve industriale, fabrikave dhe njësisve që do të prodhojnë tulla, tjegulla, çimento, clinker dhe

- materiale të tjera të ngjashme që kanë lidhje me objektin e veprimtarisë, ose në këtë çështje ngritja e bashkëpunimit ose ortakërive me persona dhe subjekte të treta,
- C. Ndërtimi i komplekseve turistike dhe banesave masive ose banesave individuale, shitja e këtyre komplekseve dhe banesave, ose në mënyrë masive transferimi tek formacionet ekonomike publike, entet publike dhe private dhe kooperativat, ose së bashku me personat fizikë ose juridikë individualisht kryerja e shitjes me pagesë cash ose me kredi pjesërisht ose plotësisht tek personat që kanë nevojë,
- D. Blerja e pasurive ta paluajtshme për nevojat e veta, shitja me kushtin që mos të kryejë ndërmjetësim, ndërtimi i godinave mbi tokë ose në emër të shoqërisë ndërtimet të realizojë nëpërmjet nënkontraktuesve ose të kryejë nënkontraktimin për komplekse të ngjashme me këto, shitja ose dhënia me qira tek personat e tretë të një pjese të këtyre ndërtesave të realizuara,
- E. Ndërtimi, vënia në funksion e impianteve, fabrikave që do të prodhojnë materiale ndërtimi të tilla si: çdo lloj çimentoje, tjegulla dhe materiale lidhëse për beton, çdo lloj betoni të gatshëm, përzierje të gatshme, suva të gatshme, suva me ngjyra të gatshme, elementëve të betonit, paneleve prodhim betoni, tubave prodhim betoni, tubave dhe pjesëve, paneleve, mureve, telave dhe kolonave, elementëve të çative, prodhimeve të strukturave parafabrikate prej betoni, strukturave të lëvizshme produkt betoni, shtylla produkt betoni, shtylla rrethimi, shtyllave të betonit për linjat elektrike, të komunikimit, etj, barrierave prodhim betoni, parvazeve, mbajtëseve të luleve, rërës, çakullit, mozaikëve, grimcave, kumtaşi, përbërjeve (agregateve) të thata të përgatitura nga materiale natyrore si rërë, çakull dhe të ngjashme me këto, si dhe angazhimi për blerjen dhe shitjen e të gjitha këtyre materialeve, gëlqeres, allçisë, gurit të allçisë, përbërjeve vullkanike, rërrës, bazaltt dhe agregatit të gurit gëlqeror, gurëve të thërmuar, tullave, tjegullave, kiremitler mahya, pllakave prej tjegulle, asmolene, gurëve të kalldrëmit, gurëve të bordurave dhe materialeve të ngjashme me këto, ose angazhimi në blerjen dhe shitjen e të gjitha këtyre materialeve,
- F. Ofrimi i shërbimeve të realizimit të ndërtimit të banesave, urave, fabrikave, kryqëzimeve me ora dhe me tunel, etj,
- G. Ngritja e impianteve të prodhimit të betonit të gatshëm, bluarjes së clinker, magazinimit dhe paketimit, ngritja dhe vënia në funksionim e fabrikave të çimentos, ose blerja dhe shitja e të gjitha këtyre materialeve,
- H. Marrja me qira, mbështetja e vendeve për ndërtimin e impianteve, në rast nevojë importimi i materialeve të ngjashme, pjesëmarrja në tendera në lidhje me shërbimet që ofron dhe me këto mallra që ka importuar ose prodhuar, ngritja e komplekseve në lidhje me shërbimet që do të ofrojë dhe materialet që do të prodhojë së bashku me shërbimet e marrjes me qira të makinerive të punës dhe mjeteve-pajisjeve të ndërtimit, kryerja e investimeve, marrja e vendeve me qira, marrja e dokumenteve përjashtuese si primet etj, tregtimi brenda dhe jashtë vendit i këtyre shërbimeve që do të ofrojë, importimi i mallrave dhe shërbimeve plotësuese ose në cilësi të ngjashme për këto shërbime që do të ofrojë, pjesëmarrja në tendera në lidhje me këto shërbime që do të ofrojë,
- I. Hapja, marrja me qira, blerja e furrave me kushtin e marrjes së lejeve të nevojshme për shërbimet dhe materialet që do të prodhojë në lidhje me objektin e veprimtarisë dhe pajisja me lejen e ushtrimit të aktivitetit, transferimi, dhënia me qira e lejeve të marra,
- J. Realizimi i importimit të çdo lloj malli, makinerie dhe pajisje për nevojat e veta,
- K. Tregtimi, eksportimi brenda dhe jashtë vendit i mallrave të prodhuara, si dhe mallrave që do të prodhohen nga persona dhe entitete të treta, ngritja e zyrave të organizimit dhe shitjes që do të mundësojnë tregtimin dhe eksportimin si dhe vënia në funksionim e tyre,
- L. Importimi i naftës dhe produkteve të naftës, si dhe çdo lloj lënde djegëse, realizimi i tregtimit me blerje dhe shitje dhe në këtë çështje ngritja e marrëdhënieve me subjektet prodhuese të naftës,

- M. Në lidhje me qëllimin e shoqërisë marrja, transferimi, marrja në dorëzim e të drejtës së markës, të të gjitha të drejtave të tjera të pronësisë industriale nga firmat brenda dhe jashtë shtetit; në lidhje me këto nxjerrja e licencave, hartimi i kontratave know-how, marrja e distributorëve dhe përfaqësimit dhe zhvillimi i tyre,
- N. Ngritja e zyrave të projektimit dhe studimit në lidhje me objektin e veprimtarisë dhe zhvillimi i tyre, po kështu sërish në lidhje me objektin e veprimtarisë në rast se është e nevojshme ngritja e ortakërive me shoqëri brenda dhe jashtë vendit, bërja e ortakërive me shoqëri të huaja (Joint-venture).

PËR REALIZIMIN E QËLLIMIT DHE OBJEKTIT TË VEPRIMTARISË

Brenda dhe jashtë vendit:

1. Blerja e tokave, truajve dhe ndërtesave, hapja, vënia në funksionim dhe marrja me qira, dhënia me qira e furrave të materialeve dhe mermerit me kushtin e pajisjes me licensat dhe lejet e nevojshme të ushtrimit të aktivitetit.
2. Ndërtimi, blerja ose marrja me qira e komplekseve të tilla si fabrika, zyra, atelje, hambarë dhe ndërtesa sociale të nevojshme, dhënia me qira pjesërisht ose plotësisht e tyre.
3. Blerja, instalimi ose marrja me qira e makinerive të punës, kamionëve të tonazhit të lehtë dhe të rëndë, kamionçinave, otomobilëve, pjesëve të këmbimit.
4. Për tregtimin e produkteve që prodhon, si dhe të çdo lloj produkti që blen dhe gjysmë produkteve që eksploron, hapja e zyrave dhe degëve brenda dhe jashtë vendit, ngritja e strukturave të shitjes dhe realizimi i bashkëpunimit me formacione që janë ngritur.
5. Hapja e zyrave dhe degëve për të gjitha punët e ndërtimit që do të bëhen në emër të shoqërisë ose për realizimin e asngazhimeve me qëllim realizimin e qëllimit, transferimi tek persona të tretë ose realizimi nëpërmjet nënkontraktorëve ose kryerja e nënkontraktimit të komplekseve të ngjashme, sigurimi dhe punësimi i personelit të nevojshëm.
6. Ngritja e kompanive, pjesëmarrja në kompani dhe holdingje që janë ngritur ose që do të ngrihen brenda kuptimit të qëllimeve të lartshënuara.
7. Dhënia e çdo lloj garancie në natyrë dhe para për sigurimin e qëllimeve të përcaktuara dhe nevojat e vetë shoqërisë, vendosja e hipotekës dhe pengjeve të tjera për pasuritë e paluajtshme të shoqërisë për kreditë që janë marrë ose do të merren në banka, vendosja e pengut mbi bizneset tregtare, pengjeve të luajtshme, pengeve mbi stoqet, nënshkrimi i letrave me vlerë tregtare nga xhiruesit e ndërmjetëm, pranimi i policave të sigurimit ose dhënia e pëlqimit.

Shoqëria në asnjë rrethanë nuk mund të japë garanci, hipotekë dhe peng në favor të aksionerëve dhe personave të 3-të. Pjesëmarrjet në të cilat është posedues i më shumë se 51% të aksioneve të shoqërisë përjashtohen nga dispozitat e këtij neni.

Po kështu, aksionerët e shoqërisë nuk mund të vendosin aksionet e shoqërisë si hipotekë, peng ose garanci në favor të personave të 3-të.

Për realizimin e qëllimit të shoqërisë, shuajë të gjitha borxhet dhe të përvetësojë të gjitha të drejtat me kushtin që të ketë lidhje me objektin e veprimtarisë; mund të blejë çdo lloj malli të luajtshëm dhe të paluajtshëm, mund ti shesë me kushtin që të mos bëjë ndërmjetësim, mund të ndërtojë ose mund të ndërtojë nëpërmjet të tretëve, mund të marrë me qira, mund të krijojë hipotekë, peng dhe të drejta ligjore të çfarëdo lloji, mund të çlirohet nga ato, mund ti dërgojë në arbitrazh, mund të ngrejë padi, mund të ngrejë shoqëri të reja me persona fizikë dhe juridikë. Mund të marrë përsipër çdo lloj angazhimi tregtar, industrial, financiar dhe juridik brenda dhe jashtë vendit të cilat janë të nevojshme për shoqërinë.

Në rast se në të ardhmen do të kërkohet që të merren përsipër edhe punë të tjera të ndryshme nga ato të paraqitura më lart dhe që do të shihen të nevojshme dhe me përfitim për shoqërinë, pas vendimit të Këshillit Administrativ do ti paraqiten për miratim Asamblesë së Përgjithshme dhe Shoqëria do të mund ti kryejë këto punë. Ky vendim që do të sjellë ndryshime në aktin e themelimit do të aplikohet pasi të jetë bërë regjistrimi dhe shpallja e vendimit.

NENI 4: SELIA DHE DEGËT E SHOQËRISË

Selia e shoqërisë është në ANKARA. Adresa është: Lagjia "Ahlatlıbel", Rruga "Incek", nr. 1, 06450 Çankaya/ANKARA.

Në rast ndryshimi të adresës, adresa e re regjistrohet në Regjistrin Tregtar dhe botohet në Gazetën e Regjistrit Tregtar të Turqisë. Njoftimi që bëhet në adresën e regjistruar dhe publikuar konsiderohet si njoftim i bërë tek shoqëria.

Edhe pse mund të jetë larguar nga adresa e regjistruar dhe e publikuar, situata e krijuar si pasojë e mos regjistrimit brenda afatit të parashikuar të adresës së re konsiderohet si arsye për shpërbërje. Shoqëria, mund të hapë degë brenda dhe jashtë vendit.

NENI 5: KOHËZGJATJA E SHOQËRISË

Kohëzgjatja e shoqërisë që nga krijimi është pa afat.

NENI 6: KAPITALI DHE NATURA E AKSIONEVE

- a. Kapitali i shoqërisë është në vlerën 50.000,00 TL (Pesëdhjetë mijë Lira Turke).
- b. Ky kapital është ndarë në 100 (njëqind) aksione të shtypura, secili me vlerë 500,00 TL (pesëqind Lira Turke).

Përkundrejt 60 aksioneve	30.000,00 Lira Turke	në emër të Cemil ÖZGÜR
Përkundrejt 10 aksioneve	5.000,00 Lira Turke	në emër të Muzaffer ÖZGÜR
Përkundrejt 10 aksioneve	5.000,00 Lira Turke	në emër të Coşkun ÖZGÜR
Përkundrejt 10- aksioneve	5.000,00 Lira Turke	në emër të Cahit ÖZGÜR
Përkundrejt 10 aksioneve	5.000,00 Lira Turke	në emër të Can ÖZGÜR

Ky kapital i zhveshur nga çdo lloj falsifikimi është marrë plotësisht përsipër nga ortakët themelues.

- c. $\frac{1}{4}$ -ta e kapitalit të shoqërisë do të paguhet jo më vonë se brenda 3 muajve nga data e regjistrimit të shoqërisë, ndërsa pjesa e mbetur prej $\frac{3}{4}$ -ve do të paguhet brenda 3 viteve.
- d. Aksionet që i përkasin themeluesve regjistrohen dhe emërtohen si aksione të grupit A.
- e. Aksionet mund të shtypen në formën e prerjeve 100,00 (Njëqind Lira Turke).

NENI 7: TRANSFERIMI, SHITJA E AKSIONEVE DHE E DREJTA E PARABLERJES:

- 7.1. Aksionet e grupit A themelues regjistrohen dhe me vendimin e Asamblesë së Përgjithshme natyra e tyre nuk ndryshon përgjithmonë.
- 7.2. Aksionet mund t'i transferohen personave të 3-të që nuk janë ortakë të shoqërisë, vetëm me vendim që do të marrë Asambleja e Përgjithshme në mënyrën që pasqyrohet më poshtë.

- a. Ortaku që do të transferojë aksionin do ti drejtohet Këshillit Administrativ me një shkresë që përmban kujt do ti transferohen aksioni/aksionet, që do ta marrë me transferim së bashku me vlerën përkatëse dhe dokumentin që vërteton mundësinë e shlyerjes së vlerës.
- b. Këshilli Administrativ këtë kërkesë për transferim dhe dokumentet që përcaktohen në pikën a, ia komunikon me shkrim ortakëve të tjerë brenda 7 ditëve pune dhe do të kërkojë nga secili prej ortakëve të tjerë të bëjnë me dije nëse duan ose jo të marrin me transferim aksionet në fjalë me kushtet në kërkesën për transferim të ortakut që kërkon t'i transferojë.
- c. Në rast se cilido prej ortakëve të tjerë do të kërkojë t'i marrë me transferim me të njëjtat kushte aksionet objekt i transferimit, është i detyruar që këtë kërkesë t'ia komunikojë me shkrim Këshillit Administrativ brenda 15 ditëve. Në rast se nuk e bën me dije, përfundon e drejta e përdorimit të të drejtës së parablerjes.
- d. Në rast se cilido prej ortakëve të tjerë komunikon si më lart kërkesën për marrje me transferim të aksioneve, ndërmjet ortakut që transferon dhe ortakut që do marrë me transferim aksionet (ortaku që përdor të drejtën e parablerjes), brenda 15 ditëve lidhet kontrata e transferimit. Kjo kontratë i paraqitet Asamblesë së Përgjithshme, në rast se Asambleja e Përgjithshme e miraton në zbatim të nenit 15.(c) të aktit të themelimit, procedura e transferimit realizohet duke u pasqyruar në librin e aksioneve procedura e transferimit.
- e. Në rast se asnjëri nga ortakët nuk e përdor të drejtën e parablerjes, në këtë rast kërkesa e ortakut për transferim i paraqitet Asamblesë së Përgjithshme. Pjesëmarrësit në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme mbledhen në zbatim të nenit 15.(d) të këtij akti themelimi. Në rast se miratohet transferimi, ndërmjet ortakut që bën transferimin dhe ortakut të ri që i merr me transferim nënshkruhet kontrata dhe i paraqitet Këshillit Administrativ. Në mënyrë që procedura e transferimit të regjistrohet në regjistrin e aksioneve, duhet që dokumenti i shlyerjes së plotë të pagesës së vlerës së aksioneve t'i paraqitet Këshillit Administrativ. Procedura e transferimit të aksioneve realizohet vetëm pas konfirmimit të kryerjes së pagesës. Aq sa në rast se procedura e transferimit de facto nuk kryhet brenda 60 ditëve nga marrja e vendimit miratues të Asamblesë së Përgjithshme, të gjitha procedurat në lidhje me transferimin e aksioneve shfuqizohen.
- f. Në rast se më shumë se një ortak kërkon të përdorë të drejtën e parablerjes për aksionet e ortakut që kërkon t'i transferojë, kontrata e transferimit lidhet me ortakun me të cilin ortaku që do të bëjë transferimin dëshiron të bëjë transferimin ndryshe nga ortakët e tjerë, kontrata e transferimit i paraqitet Asamblesë së Përgjithshme. Për rrjedhojë pas miratimit që do të merret nga ortakët që nuk kanë përdorur të drejtën e parablerjes, në zbatim të nenit 15.(d) të aktit të themelimit kontrata e transferimit regjistrohet në regjistrin e aksioneve dhe në këtë mënyrë realizohet transferimi. Edhe në një transferim të tillë Këshilli Administrativ ka të drejtë të shqyrtojë dokumentacionin në lidhje me pagimin ose jo brenda 60 ditëve të vlerës së aksioneve nga vendimi miratues i Asamblesë së Përgjithshme, në çfarëdo lloj situatë duke patur të drejtën për të anuluar procedurën e transferimit.
- 7.3. Transferimi i aksioneve tek nëna, babai dhe vëllezërit, motrat dhe fëmijët nuk i nënshtrohet lejes së Këshillit Administrativ ose Asamblesë së Përgjithshme pa parë nëse është ose jo themelues ose aksioner.
- 7.4. Në transferimin e aksioneve të kryer tek personat e tretë jashtë fëmijëve dhe nipërve të ortakëve themelues, d.m.thënë tek personat e tretë që nuk kanë lidhje gjaku të shkallës së parë dhe të dytë të familjes themeluese, aksionet objekt i transferimit kthehen në grupin B. E humbin cilësinë e aksioneve të grupit A.
- 7.5. Aksionet që përftohen me rrugën e trashëgimisë ruajnë cilësinë e grupit A.
- 7.6. E drejta e votës në Asamblesë e Përgjithshme e një aksioni të grupit A është katërfishi i një aksioni të grupit B.
- 7.7. Aksionerët nuk mund të lënë peng asnjë aksion të shoqërisë përkundrajt një kursimi. Aksionerët nuk mund të kërkojnë nga Këshilli Administrativ pasqyrimin në regjistrin e

- aksioneve të pengut të aksionit. Një kërkesë e tillë trajtohet me lejen që do të japë Asambleja e Përgjithshme e ortakëve në përputhje me nenin 15/d të aktit të themelimit.
- 7.8. Aksionet që merren me bono në para të pengut ose me rrugën ekzekutim-sekuestrim, e humbin cilësinë e grupit A. Këto aksione regjistrohen si aksione të grupit B.
- 7.9. Transferimi pjesërisht ose plotësisht i të drejtës të uzufruktit të cilëso prej aksioneve trajtohet me lejen që do të japë Asambleja e Përgjithshme në zbatim të nenit 15/d të aktit të themelimit. Duhet kuptuar që nuk bëhet transferim i të drejtës të uzufruktit me një afat më shumë se 15 vjet.
- 7.10. Aksioni nuk ndahet përkundrejt shoqërisë. Në rast se një aksion ka më shumë se një pronar, këta të drejtat e tyre përkundrejt shoqërisë mund ti përdorin nëpërmjet një përfaqësuesi. Në rast se nuk kanë caktuar përfaqësues, komunikimi që do t'i bëhet nga shoqëria njihërit prej tyre konsiderohet i komunikuar tek të gjithë.
- 7.11. Që transferimi i aksioneve të përfaqësojë një vendim kundër Shoqërisë, që marrësi me transferim të mund të përdorë të drejtën e votës në Asamblesë e Përgjithshme dhe që të përfitojë nga të drejtat e tjera që i njihen aksionerëve, lidhet me pasqyrimin në Regjistrin e Aksioneve të Shoqërisë mbështetur në një vendim të Këshillit Administrativ mbi transferimin.

Marrësi në dorëzim i aksionit të transferuar duke iu drejtuar Këshillit Administrativ mund të kërkojë pasqyrimin e transferimit të aksioneve në regjistrin e aksioneve.

Përftimi i aksioneve nga një person fizik ose juridik, si rezultat i kapërcimit me 10% (dhjetë përqind), 20% (njëzetë përqind), 33% (tridhjetë e tre përqind) ose 50% (pesëdhjetë përqind) të kapitalit të shoqërisë dhe transferimi i aksioneve të dhëna si rezultat i zbritjes së aksioneve që i përkasin një ortaku nën nivelet e mësipërme, i nënshtrohen lejes së shumicës së votave të Këshillit Administrativ. Pas lejes që do të jepet nga Këshilli Administrativ i paraqitet për miratim Asamblesë së Përgjithshme. Regjistrimet në Regjistrin e Aksioneve që bëhen kundër kësaj dispozite janë të pavlefshme. Transferimet që kryhen në kuadrin e nenit 7.3 që rregullon transferimin e aksioneve, janë përjashtuar nga kuadri i kësaj dispozite.

NENI 8: DETYRIMET E ORTAKËVE DHE PËRGJEGJËSITË NDAJ NJËRI-TJETRIT

Aksionerët janë përgjegjës në sasinë e vkerës së aksioneve që posedojnë. Nuk kanë asnjë përgjegjësi më tepër se sasia që kanë marrë angazhim.

NENI 9: RRRITJA, PAKËSIMI I KAPITALIT DHE EMËTIMI I BONOVE

Aksionerët prezentë në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme mblidhen në zbatim të nenit 15.(d) të këtij akti themelimi dhe kapitali i Shoqërisë në këtë mënyrë mund të shtohet ose të pakësohet.

Në zbatim të Ligjit Tregtar Turk dhe dispozitave të tjera të legjislacionit përkatës, sipas bilancit të paguar dhe të vërtetuar të kapitalit themeltar deri në sasinë që kuptohet se posedohet nga ana e Asamblesë së Përgjithshme mund të vendoset për emëtimin e bonove. Por në rast se nuk paguhet plotësisht vlera e bonove të nxjerra më parë, nuk lejohet emëtimi i bonove të reja. Asambleja e Përgjithshme ashtu sikurse mund t'i konstatojë vetë kushtet e emëtimit të bonove, në këtë çështje mund të autorizojë Këshillin Administrativ.

NENI 10: ZGJEDHJA E ANËTARËVE TË ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME DHE NDARJA E DETYRAVE



Punët dhe administrimi i shoqërisë drejtohen nga Këshilli Administrativ i përbërë jo më pak se 3 (tre) anëtarë që do të zgjidhen nga Asambleja e Përgjithshme ndërmjet aksionerëve që do të ushtrojnë detyrën për një periudhë jo më shumë se 3 (tre) vjet në zbatim të Ligjit Tregtar Turk dhe dispozitave të këtij akti themelimi.

Si anëtarë të parë të Këshillit Administrativ janë zgjedhur Cemil Özgür, Çokun Özgür dhe Cahit Özgür.

Në drejtimin e Këshillit Administrativ është zgjedhur Cemil ÖZGÜR, si anëtarë të Këshillit Administrativ janë zgjedhur Coşkun ÖZGÜR dhe Cahit ÖZGÜR.

Anëtarët e Këshillit Administrativ të cilëve iu mbaron afati i detyrës mund të rizgjidhen.

Në rast se Asambleja e Përgjithshme e sheh të nevojshme, anëtarët e Këshillit Administrativ mund të ndryshojnë në çdo kohë dhe në zbatim të dispozitave të Ligjit Tregtar Turk numri i anëtarëve të Këshillit Administrativ mund të shtohet ose të pakësohet.

Në rast se për shkak të dorëheqjes, shkarkimit ose shkaqeve të ngjashme lirohet një vend në anëtarësinë e Këshillit Administrativ, anëtarët e tjerë të Këshillit Administrativ për të zgjedhur anëtarin e ri, jo më vonë se brenda 30 ditëve në zbatim të nenit 15.(d) të këtij akti themelimi thërret në mbledhje Asambleja e Përgjithshme. Asambleja e Përgjithshme gjedh anëtarin e ri të këshillit administrativ.

Asambleja e Përgjithshme në çdo kohë mund të shkarkojë nga detyrë pa arsye një ose disa nga anëtarët e këshillit administrativ dhe në përputhje me dispozitat e këtij Akti Themelimi dhe Ligjin Tregtar Turk mund të emërojë të tjerë. Anëtarët e këshillit administrativ që shkarkohen në këtë mënyrë nuk kanë të drejtën për të kërkuar dëmshpërblim.

NENI 11: PËRFAQËSIMI DHE PËRGJEGJËSIA PËR SHOQËRINË DHE NDARJA E DETYRAVE

1. Menaxhimi i shoqërisë dhe përfaqësimi tek të tjerët i shoqërisë dhe e drejta e vendimmarrjes në këto çështje i përket Këshillit Administrativ.

Sipas kësaj:

A- PËRFAQËSIMI I PËRGJITHSHËM: Përfaqësimi dhe përgjegjësia në emër të shoqërisë në çështje të përgjithshme të tilla si çdolloj kursimi dhe transaksioni me dëshirë dhe të gjitha kontratat e tenderave të shoqërisë sonë në zyrat shtetërore, institucionet financiare publike, bashkitë, zyrat dhe entet private, bankat publike dhe private, sindikata, organizatat e pavarura, subjektet fizike dhe juridike, personat e tretë dhe bizneset branda kufijve të Republikës së Turqisë, po kështu në procedurat e pagesave të tilla si çdo lloj urdhër transferte, dërgese dhe eft, etj, në çështjet e përpilimit dhe marrjes së formularit të letrave të garancisë provizore ose të përtheshme, kryhet me nënshkrimin e vetëm individual të njërit prej anëtarëve të Këshillit Administrativ,

B- PËRFAQËSIMI NË ÇËSHTJET FINANCIARE: Gjatë marrjes nga ana e shoqërisë sonë të borxheve me obligacione, bono, çek, policë ose me çfarëdo lloj dokumenti pranë bankave, institucioneve, institucioneve publike dhe jo publike, po kështu gjatë tërheqjes së parave nga llogaritë kreditore pranë bankave, gjatë nënshkrimit të kontratave të kredive, po kështu në procedurat e shitjes së pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme të shoqërisë, përfaqësimi dhe marrja e përgjegjësisive në emër të shoqërisë bëhet me nënshkrimin e përbashkët të dy prej cilëve do anëtarë të Këshillit Administrativ.

2. Në respektim të dispozitave përkatëse të Ligjit Tregtar Turk, Këshilli Administrativ: organizon mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme, përgatit raportet e veprimtarisë, bilancin dhe buxhetin e parashikuar që do të jenë rendi i ditës i vendimeve të Asamblesë së Përgjithshme, i paraqet për miratim Asamblesë së Përgjithshme planet dhe programet në lidhje me aktivitetet e shoqërisë dhe projekt vendime që përmbajnë propozimet e projekteve dhe vendimet e marra në asamblenë e përgjithshme i ekzekuton në emër të shoqërisë, në lidhje me këto bën organizimet e nevojshme dhe punëson personelin.

NENI 12: DETYRAT E KËSHILLIT ASMINISTRATIV:

- 1- Ekzekutimi i detyrave të Këshillit Administrativ dhe vendimeve të Asamblesë së Përgjithshme, në kuadrin e dispozitave të ligjit dhe aktit të themelimit thërret në mbledhje Asamblenë e Përgjithshme, blerja dhe përfitimi i pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme të emër të shoqërisë dhe çdolloj të drejte materiale, blerja për shoqërinë e pasurive të paluajtshme të nevojshme duke zgjedhur vendin, marrja dhe dhënia me qira e pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme të çdo lloji që do të shihen të nevojshme nga shoqëria, dhënia e vendimeve për kryerjen e investimeve në emër të shoqërisë, mundësimi i kredive afatshkurta, afatmesme dhe afatgjata duke ndërtuar marrëdhënie me institucionet kreditore brenda dhe jashtë vendit për fuqizimin e investimeve të shoqërisë dhe marrja hua në emër dhe llogari të shoqërisë kreditë në natyrë dhe në para që do të mundësohen, të japë hua shoqërinë tek persona të tretë në çështjet që i interesojnë.
- 2- Në interes të shoqërisë dhënia e vendimit për të marrë pjesë me aksione në kompanitë dhe holdingët që janë krijuar ose do të krijohen.
- 3- Dhënia e vendimit për zgjerimin ose ngushtimin e çështjeve të aktivitetit të shoqërisë nën kushtet aktuale.
- 4- Ngritja e zyrave të komunikimit brenda dhe jashtë vendit me qëllim zhvillimin si duhet të punëve të shoqërisë.
- 5- Lidhja e kontratave të licencimit dhe projektimit me firma jashtë shtetit dhe vënia në zbatim e këtyre kontratave, si dhe punë të tjera të ngjashme me këto përbëjnë detyrat kryesore të këshillit administrativ.
- 6- Anëtarët e Këshillit Administrativ nuk i nënshtrohen kufizimeve të neneve 334 dhe 335 të Ligjit Tregtar Turk. Kjo dispozitë përfshin të gjitha anëtarët e këshillit administrativ aktualë dhe ata që do të zgjidhen rishtas.

NENI 13: PAGESAT E ANËTARËVE TË KËSHILLIT ADMINISTRATIV

Pagesa që do ti jepet anëtarëve të Këshillit Administrativ përcaktohet nga ana e Asamblesë së Përgjithshme. Por, nëse anëtarët vijnë nga qytete të tjera, i paguhen edhe pagesat e udhëtimit dhe shpenzimet.

NENI 14: AUDITUESIT DHE DETYRAT

- 1- Audituesit zgjidhen nga Asambleja e Përgjithshme qoftë ndërmjet aksionerëve, qoftë nga jashtë për një afat jo më shumë se tre vjet. Pagesa që do ti bëhet audituesve përcaktohet nga Asambleja e Përgjithshme.
- 2- Audituesit mund të jenë një ose më shumë se një, por numri i tyre nuk mund t'i kalojë dy persona.

Emri mbiemri
Turhan ÖZEREN

Adresa e banimit:
Lagjia "Ahlatlıbel", Rruga "Incek", nr, 1
06450 Çankaya/ANKARA

Shtetësia:
Republika e Turqisë

Është zgjedhur për një periudhë 1 (një) vjeçare.

- 3- Audituesit janë përgjegjës të kryejnë detyrat e parashikuara në nenet 353-357 të Ligjit Tregtar Turk.

NENI 15: THIRRJA E MBLEDHJES SË ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME DHE RENDI I DITËS



1- Në mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme do të zbatohen elementët e mëposhtme:

a) Ftesa në mbledhje dhe forma:

Thirrja e Asamblesë së Përgjithshme kryhet në zbatim të dispozitave të neneve 355, 365, 366 dhe 368 të Ligjit Tregtar Turk. Asambleja e Përgjithshme në zbatim të nenit 370 të Ligjit Tregtar Turk mund të mbledhet edhe pa zbatuar procedurat bazë.

Në ftesat dhe njoftimet e gazetave përveç çështjeve që parashikohen në dispozitat e Ligjit Tregtar Turk, përcaktohet edhe se nga cila datë dhe ku do të jenë gati për shqyrtim nga ana e aksionerëve bilanci i shoqërisë, llogaritja e fitimit dhe dëmit, raporti i aktivitetit i Këshillit Administrativ dhe raporti i Audituesit.

Rendi i ditës përcaktohet he konstatohet nga Këshilli Administrativ dhe kur është e nevojshme nga ana e Audituesve. Po kështu, mbështetur në kërkesat me shkrim për shkaqe të nevojshme të aksionerëve që posedojnë aksione në vlerën jo më pak se një e dhjeta (1/10) e kapitalit të shoqërisë, është e detyrueshme që të vendosen në rendin e ditëste mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme çështjet e kërkuara.

b) Koha e Mbledhjes:

Asambleja e Përgjithshme e Zakonshme e Shoqërisë; mbledhet dhe merr vendimet e nevojshme minimalisht një herë në vit dhe brenda 3 muajsh nga përfundimi i transferimit të llogarisë të shoqërisë; ndërsa Asambletë e Përgjithshme të Jashtëzakonshme mbledhen dhe marrin vendimet e nevojshme në rastet dhe kohën kur e bëjnë të nevojshme punët e shoqërisë.

c) Votimi dhe emërimi i përfaqësuesit:

(1) Në mbledhjet e zakonshme dhe të jashtëzakonshme të Asamblesë së Përgjithshme aksionerët ose përfaqësuesit e tyre që janë të pranishëm, për aksionet e grupit A kanë 4 (katër) të drejta vote për çdo kuotë, për aksionet e grupit B kanë 1 (një) të drejtë vote për çdo kuotë.

(2) Në mbledhjet Asamblesë së Përgjithshme aksionerët mund të përfaqësohen personalisht ose kur nuk janë vetë të pranishëm nëpërmjet përfaqësuesve që ata vetë emërojnë. Përfaqësuesit që janë aksionerë në shoqëri, janë të autorizuar të përdorin edhe votat që posedojnë aksionerët që përfaqësojnë. Për formën e dokumentit të autorizimit në zbatim të udhëzimit përkatës Këshilli Administrativ është përgjegjës për emërimin dhe konstatimin. Aksioneri që do të përfaqësohet me përfaqësues, është i detyruar të përcaktojë në prokurën që do të përgatisë se për cilën datë që do të zhvillohet asambleja e përgjithshme është e vlefshme.

d) Kuorumi i vendimeve të mbledhjes:

Mbledhjet e njoftuara të zakonshme dhe të jashtëzakonshme të Asamblesë së Përgjithshme në çdo rast zhvillohen me pjesëmarrjen e ortakëve që posedojnë minimumi 60% të kapitalit total.

Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme pa parë përqindjen e pjesëmarrjes në mbledhje të ortakëve, merren me votat e minimumi 60% të kapitalit total të shoqërisë.

e) Zhvillimi i diskutimeve:

Në mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë: çështjet e rendit të ditës të konstatuara, hartuara dhe pranuar nga Këshilli Administrativ dhe çështjet e përmendura në nenin 369 të Ligjit Tregtar Turk diskutohen dhe merren vendime.

f) Vendi i Mbledhjes:

Mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme zhvillohen në adresën e selisë së shoqërisë ose në një vend tjetër të përshtatshëm të qytetit që konstatohet dhe deklarohet i përshtatshëm nga ana e Këshillit Administrativ, aty ku ndodhet qendra e administrimit të shoqërisë.

g) Prania e komisionerit të qeverisë në mbledhje:

Si në mbledhjet e zakonshme, dhe ato të jashtëzakonshme të Asamblesë së Përgjithshme është e detyrueshme prania e komisionarit që përfaqëson Ministrinë e Industrisë dhe Tregtisë, si dhe nënshkrimi nga ana e tij i proces-verbaleve të mbledhjes së bashku me të tjerët.

Në mbledhjet që do të zhvillohen pa prezencën e Komisionerit të Qeverisë vendimet që do të merren dhe proces-verbalet e mbledhjes që nuk janë të nënshkruara nga Komisioneri do të konsiderohen të pavlefshme.

NENI 16: ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME, PËRBËRJA E KRYESISË SË KËSHILLIT:

Mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme hapen nga Kryetari i Këshillit Administrativ dhe në mungesë të tij nga Anëtari i Këshillit Administrativ, për zhvillimin në formë të rregullt të mbledhjes së asamblesë së përgjithshme ndërmjet anëtarëve të Asamblesë së Përgjithshme zgjidhet një kryetar i këshillit. Po kështu zgjidhet një sekretar dhe një numërues i votave.

Kryetari i Divan mundëson zhvillimin e mbledhjes dhe diskutimeve në kuadrin e rregullave dhe elementeve që shihen të përshtatshme.

Në mënyrë që vendimet e asamblesë së përgjithshme të jenë të vlefshme, është e nevojshme që të mbahet një proces-verbal që përmban arsyet e dakortësimin me qëllimin dhe rezultatet e këtyre vendimeve.

NENI 17: DETYRAT DHE KOMPETENCAT E ASAMBLESE SË PËRGJITHSHME

- 1- Asambleja e Përgjithshme është organi më i lartë kompetent i shoqërisë.
- 2- Kryen detyrat dhe përdor kompetencat që përcaktohen në dispozitat përkatëse të Ligjit Tregtar Turk.
- 3- Me Këshillin Administrativ dhe Audituesit diskuton, pranon ose kundërshton raportet e veprimtarisë.
- 4- Diskuton propozimet mbi bilancin, llogaritjen e fitimit/humbjes dhe shpërndarjen e fitimit të shoqërisë. E pranon ose e kundërshton.
- 5- Përcakton pagesat që do ti paguhen anëtarëve të Këshillit Administrativ dhe Audituesve.
- 6- Mundëson rizgjedhjen ose ndryshimin e audituesve dhe anëtarëve të Këshillit Administrativ të cilëve iu ka përfunduar afati i detyrës.
- 7- Cilido qoftë organizimi, prodhimi, tregtimi, financimi, produktiviteti dhe sasia e biznesit të shoqërisë, në çështjen e çfarëdo lloj investimi diskuton dhe vendos mbi politikën e përgjithshme.
- 8- Në rast se është e nevojshme vendos për grante ose pranimin e grantit të dhënë.

NENI 18: SHPALLJA

- 1- Shpalljet që i përkasin shoqërisë me kushtin e rezervuar në dispozitat e parashikuara në pikën 4 të nenit 37 të Ligjit Tregtar Turk bëhen në një gazetë që botohet në vendin ku ndodhet selia e shoqërisë dhe jo më pak se para 15 ditëve.
- 2- Për shpalljet që i përkasin thirrjes në mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme në zbatim të nenit 368 të Ligjit Tregtar Turk është e detyrueshme të shpallen jo më pak se dy javë përpara, pa përfshirë ditët e mbledhjes.
- 3- Për shpalljet që kanë lidhje me pakësimin e kapitalit ose likuidimin e tij, zbatohen dispozitat e neneve 397 dhe 438 të Ligjit Tregtar Turk. Në zbatim të nenit 370 të Ligjit Tregtar Turk në mbledhjet e kryera nuk kërkohet formaliteti i shpalljes.

NENI 19: PERIUDHA E LLOGARIVE

- 1- Viti financiar i shoqërisë fillon në ditën e parë të muajit janar dhe përfundon në ditën e fundit të muajit dhjetor.



- 2- Por viti i parë financiar i shoqërisë fillon nga data kur është krijuar në mënyrë permanente shoqëria dhe përfundon në ditën e fundit të muajit dhjetor të atij viti.

NENI 20: LLOGARITJA DHE SHPËRNDARJA E FITIMIT

- 1- Pasi shpenzimet e përgjithshme dhe amortizimet e shoqërisë të zbriten nga të ardhurat që janë konstatuar në und të vitit financiar, sasia që mbetet përbën fitimin bruto. Kështu nga fitimi i përfutur ndahet "Fondi rezervë ligjor" në masë 5%. Shuma e mbetur zbritet nga shuma e mbetur në dividendin e parë në masën 5% ndaj pjesës së paguar. Nga pjesa e mbetur pasi ndahen tatimet ligjore të nevojshme, nga pjesa e fitimit që mund të shpërndahet, minimalisht 25% e tij i shpërndahet aksionerëve në përputhje me aksionet ose nëse ka element të zbritjes së paradhënies të dividendit, nga ana e ortakëve të shoqërisë është vendosur me këtë akt themelimi. Por fitimet që mbesin jashtë 25%'it të shpërndarë, se në cilën masë dhe në çfarë mënyre ose në çfarë forme do të shpërndahen është e autorizuar Asambleja e Përgjithshme. Fitimet që janë shpërndarë në përputhje me dispozitat e kësaj kontrate, nuk kthehen mbrapsht. Por Asambleja e Përgjithshme është e autorizuar ta rrisë ose ta ulë këtë përqindje. Në vendimet për rritjen e kapitalit duke mos shpërndarë fitimin ose vendosjen ekstra në fondin rezervë, në zbatim të nenin 15.(d) të këtij akti themelimi, është kusht pjesëmarrja e aksionerëve dhe përdorimi i votave miratuese. Këshilli Administrativ me kushtin që mos të kalojë 5% të xhiros së shoqërisë brenda vitit, mund të vendosë shpërndarjen paradhënie të dividendit tek ortakët.
- 2- Nga paratë që vendosen për tu shpërndarë tek aksionerët si pjesë e dividendit dhe që i shpërndahen shoqërive pjesëmarrëse në fitim, në zbatim të paragrafit të 3-të të pikës së 2-të të nenit 466 të Ligjit Tregtar Turk, zbritet një sasi në masën 10% dhe ndahet normalisht për "Fondin Ligjor Rezervë".

NENI 21: FONDI REZERVË

Mbështetur në propozimin e Këshillit Administrativ Asambleja e Përgjithshme konstaton çdo vit sa sasi do të ndahet nga fitimi vjetor neto i shoqërisë, për fundit fakultativ/ligjor rezervë me kushtin që të mos jetë me i vogël se një nga njëzetë. Në lidhje me fondet fakultative që ndahen nga ana e Shoqërisë zbatohen nenet 466 dhe 467 të Ligjit Tregtar Turk.

NENI 22: DISPOZITAT LIGJORE

Në lidhje me çështjet që nuk janë parashikuar në këtë akt themelimi zbatohen dispozitat përkatëse të legjislacionit Turk në lidhje me Ligjin Tregtar Turk.

DISPOZITA KALIMTARE

Referuar nenit 11 me titull përfaqësimi, përgjegjësia për shoqërinë dhe ndarja e detyrave, të këtij akti themelimi, Kryetari i Këshillit Administrativ Cemil ÖZGÜR së bashku me Anëtarët e Këshillit Administrativ Coşkun ÖZGÜR dhe Cahit ÖZGÜR, në përputhje me nenin 11 të kësaj kontrate në çështjet e përgjithshme dhe financiare të shoqërisë janë të autorizuar për përfqësimin dhe përgjegjësinë nëpërmjet nënshkrimit poshtë emrit të Shoqërisë.

ORTAKËT THEMELUES

Cemil ÖZGÜR

(Vulë: Në kopjen origjinale ka nënshkrim)

Muzaffer ÖZGÜR

(Vulë: Në kopjen origjinale ka nënshkrim)

Çoşkun ÖZGÜR

(Vulë: Në kopjen origjinale ka nënshkrim)

(Vulë-Nënshkrim)



(Vulë lidhëse)

APOSTILË
(Marrëveshja e Hagës e datës 5 Tetor 1961)

1. Shteti : **TURQI**

Ky dokument zyrtar

2. Është nënshkruar nga **Ilknur YAKAR**
3. Funksioni i nënshkruesit: **Zv. Drejtor**
4. Mban vulën e **Drejtoria e Regjistrit Tregtar të Ankarasë**

VËRTETIM

5. Në **Prefekturën e Çankaya.**
6. Në datë **16.12.2019**
7. Nga **Përgjegjës, Ferah Diba ARSLAN**
8. Është konfirmuar me **Nr. 106516**
9. Vula

(Vulë-Nënshkrim)
10. Nënshkrimi

(Vulë-Nënshkrim)

Manjola SOPOTI
Përkthyesë Zyrtare
e Gjuhës Turke
Cel: 0682091177

Sopoti

REPubLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERISË TIRANË
NR. 9292 REP



VËRTETIM

NËNSHKRIMI PËRKTHIMI

Në Tiranë, sot më 20.12.2019 (dymijë e nentëmbëdhjetë), prej meje noterit publik, Anëtar i Dhomës së Noterisë Tiranë, vërtetohet firma e përkthyeses së autorizuar nga Ministria e Drejtësisë për përkthim zyrtar në gjuhën Turke, Znj. Manjola Sopoti, e cila përktheu dokumentin bashkëlidhur nga gjuha Turke në gjuhën Shqipe dhe e nënshkroi atë sipas rregullave.

Përsa më sipër, bazuar në nenin 135 të ligjit Nr. 110/2018, "Për Noterinë", vërtetoj nënshkrimin e përkthyeses.



NOTER